

EGLANTINA BAKIU
DITAR NË VARGJE
POEZI

BOTIMET TOENA

EGLANTINA BAKIU

DITAR NË VARGJE

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Kopertina dhe përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817013

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

*Nuk e mendoja se zonja Irena do të më jepte një dorë
e do të pëlqente krijimet e mia që flinin nëpër sirtarë.*

*Mirë thonë, artisti nuk largohet nga skena
pa shkëlqyer edhe një herë në moshë të vonë.*

Edhe pse, si thotë Napoleoni i madh:

“Arti është i gënjeshtërt”,

të gjithë duan të gënjehen nga pak...

Periudhë

Në moshën e re
Shkëlqen vetë rinia,
Kur rritesh
Veten shikon në
Pasqyrë,
Kur veten kupton,
Nga tjetri kërkon
Të marrësh,
Kur e di se je pjekur,
Ki kujdes se gabon!

1986

Në shpirtin tim

Mëngjesi, vjen i bukur
E unë mezi hap sytë,
Nga gjumi i thellë i natës
I natës ëndrrashumë.

Mëngjesi vjen i bukur
Një arrati më kap,
Të iki, të largohem
Diku sa më larg.

Sa bukur ky mëngjes
S'ka zhurmë nëpër rrugë,
Ndoshta të gjithë si unë
Arratinë kanë në tru.

Dikur me vrap kam dalë
Tani zë vend nostalgjia,
Arratia u bë fjalë e huaj
Në çapitjet e mendimet e mia.

Romanca

Ia mora puhizën
Mëngjesit.
E ndjeva zbardhësinë
E tij
Nga vesa, amori
I natës u lava,
E vesa mbeti si lot
Në sytë e mi.
Agimit të parë i thashë
Mirëmëngjesi!
Burimet vezulluan
Nga të parat rreze,
E morën përshkuan
Fushat plot shpresë
Si gjaku që përshkon
Dejet...

Kujtoj se çdo gjë
Më kishte ikur.
Ndieja
Se jetohe vetëm
Në rini...
Më thuaj sa e gjatë
Është jeta
Të të them,
Në ç'moshë je ti.

Fillim i mbrapshtë

E shoh që të kam
Humbur
Tek vë buzët te filxhani,
Me kakao të nxehtë.
E fshihem pas kësaj
Shijeje
Me ngjyrë të errët
Për të mos tradhtuar
Fytyrën nga skuqja
E lehtë.
E skuqja kraharorin
Më dogji.
Një natë e ndjeva kur
Mbizotëroi,
E veshur me vel,
Qetësia.
Sytë lot pa dashur
Më ranë,
E më treguan për atë
Që kisha humbur
Kohë më parë.

Malli i pashuar

Çfarë është largësia për një nënë?
Një urë që lidh dy brigje!

Çfarë është largësia për një nënë?
Një mall i pashuar!

Çfarë është largësia për një nënë?
Një lot në faqe!

Çfarë bën një nënë nga largësia?
Dërgon urata që kur lind dielli,
E deri në perëndim!

Çfarë e afron me largësinë?
Shpresa siç di vetëm ajo të presë!

Çfarë është torturuese për një nënë,
Nisja,
apo pritja?!

Çast pushimi në studio

Jam këtu, të gjithë lëvizin,
Hapi i tyre nuk ngjan me paradën.
Unë e palëvizur rri
Dhe sytë hedh nga qielli.
Bëj not në hapësirë,
Pa parashutë shpëtimi!

Jam këtu në studio,
Jo në restorante gjermane,
Jo mbi kulla të larta
Modernizma...

Jam tek i njëjti vend
Si tani e shumë vite,
Po duke kënduar...
Vetëm kam ndërruar dirigjent
Një me baketë e një pa baketë!

Gati dirigjenti të ngrrejë duart
E unë të këndojsim Simfoninë e 9-të!

E bukur jeta si Kleopatra

Si Kleopatra
Një vajzë unë linda,
Pa pasuri, pa frone,
Mes shpifjesh
Të njerëzve pa shpirt.
U bë histori.
Ja historitë si përsëriten
Për frone të vogla.
Në jetë njerëzish
Pa dashur bëhen dramë.
E krijohen
Armiqësi mes
Dy fisesh.
Por ti, princeshë,
Pa kurorë, s'kupton dot
Luftën e mosdashjes.
Se ty s'të mungon
Mbretëria,
Mbretëria e dashurisë
Së nënës.

Unë linda një vajzë
Si Kleopatra,
Por luftë s'shpalla
Për fron.
Ti je princeshë
E dashurisë,
Princeshë e nënës,
Që të fal
Mbretëri.
Ta dish, bijë,
E kisha një unazë në gisht,
E drejta ime për të të lindur ty.

Dremitje e syve

Mbrëmja po ulej ngadalë
Në gjunjët e tokës...
Mbrëmja po binte ngadalë
Të fshihte përflakjen e horizontit...
Mbrëmja po vinte ngadalë
Si dremitja e syve,
Si sipari i një fundi opere...

Mbrëmja iku!
Nata zu fill!

Të lodhur njerëzia thanë:
“Natën e mirë!”.

Peizazh

Mbi barin e njomë u ula
Lulet e shegës
Më binin vallëzuar mbi fustan.
Lulet e mollës diku më larg
Po çelnin ngadalë.

Një flutur mbi mua
Erdh e u ul,
Si faqe e një romani të vjetër
S'e ngava me duar.
As nga goja frymë nuk nxora.

Kush shpirt më vinte afër?!
Babai...
Me endje e sodita
Kujtime mall...
Kjo flutur e bukur
Më bëri të qaj.

10 mars 2015

Çok sevjurum

Çok sevjurum

Mbeti për atë
Në degët e dafinës
E nderë dhe jetime
Dhe fle atje
Mbi shekulloren pemë.

Çok sevjurum

Nuk zbriti kurrë për të,
E as t'i futej në lëkurë
As mbi kokë
T'i qëndronte si
Kurorë,
E të niste të
Mbretëronte
T'i bënte buzët t'i skuqeshin
E shpirti t'i gufonte.

Çok sevjurum,

Kurrë nuk erdhi për të
E ajo kokëfortë
As gishtin s'e luajti
Për ta fituar...
Mbi dafina e la,
E me erën të përkundej...

Mikeshë që vjen nga larg

Borë, moj dëborë,
Magji diçka ti ke,
Më bëre që të dal
Oxhakun flakë ta lë!

Borë, moj dëborë,
Lashë zjarrin bubulak,
M'u thanë duar e faqe
Për të të prekur pak!

Borë, moj dëborë,
Mikeshë që vjen nga larg,
Do gjuaj për të luajtur
E jo kë kam inat.

Dëborë, e bardha borë,
Magji të bukur ke,
Më bëre që të dal
Oxhakun flakë ta lë.

Merak nëne

Kush botën njeh, në sy të sheh,
Kush di të mendojë, di dhe të presë,
Kush di të qeshë, ka dashuri,
Kush di të falë, di dhe të lutet,
Kush lule mbjell, di dhe të dojë,
Kush ta di hallin, di dhe të mbrojë.

Kush di të qajë, di dhe të gëzojë,
Kush di të dojë, di dhe të urrejë,
Kush di të afrojë, di dhe të largojë,
Gjithmonë pranë teje
Do të më gjesh...

Bija ime

- Për vajzën time Dora, që studion piano në Verona -

Të dua shumë, bija ime
Dielli i vetëm që më ngroh,
Të dua shumë, hënëza ime
Që vetëm ti rrugën ma tregon!

Aurora të pagëzova
Si agimi që lind,
Që dritën pranë ma sjell
Më lumturon si prind!

Ti je dielli i vetëm
Që më ngroh mua,
E ëmbla e kësaj bote
Gjithmonë pranë të dua!

21 nëntor 2019

Grua

Unë rri e heshtur,
E heshtur si mosha ime.
Edhe pse më lajkatojnë,
Barbi 50 vjeçe,
Nuk di pse e largoj
Një motiv dashurie,
Pres të më ftojnë,
Si vajzë
Të ndihem.
Të skuqem.

S'jam më pranvera,
Si vjeshta e gjej veten.
E heshtur rri, pa fjalë,
Si gur, që ditët e mia të veniten.
Si netët pa hënë,
Si qiell gri,
Heshtja s'më lë të
Guxoj,
Edhe pse e tradhtuar
Nga ndjenjat e mia!

Mosbesim

Pse bëj sikur nuk dua
Të kem dikë pranë?

Por thonë se të gjithë tradhtojnë.
E unë s'e pranoj dot tradhtinë.

Prandaj s'dua të kem dikë
Afër e pranë!

Po mallin si ta shuaj?

Ta dish se më merr malli,
Dhe pse jam zemëruar!
Ta dish se nuk fal
Po mallin si ta shuaj?

Ta shuaj me një lot
Kam frikë se zvogëlohem,
Por lotin do ta ruaj
Ta ruaj kur të gëzohem!

Libri

Me të vërtetë
Më je gjendur shok,
Kur shoqet e mia
Udhëtonin nëpër botë.

Dhe unë me ty isha
Te Harku i Triumfit
Në kafenetë e natës,
Ku pihej *Calvados*!

S'ka gjë se ti ke vite
Më shumë,
E unë të lexoj
Në kohë tjetër.

Prapë ti edhe mua
Do të më plakësh,
E prapë pija e parë
Për të kujtuar
Do të mbetet
Calvados-i!

Parfum
(opium)

Lulëkuqe bukuroshe,
Kush dorë vë mbi ty,
E s'të lënë të kuqëlosh
Fushat e gjera
Plot me grurë?

Lulëkuqe, s'ke faj ti,
Të të mbajnë nëpër
Gojë,
Të të mbledh, të bëj
Kurorë!

Gjumin e natës
E bëj të mirë,
Ne me gjemba
Të përziejmë,
Në kazan të humbim
Ngjyrë.

Duan namin
Të të hapin,
Që për vete të të gllabërojnë,,
Një dorë e keqe lakmitare,
Nuk e dinë
Ç'pësojnë nga ti...

Narcis

- Mitologji -

Gjithmonë bukuria vret.
Në kohët e sotme
“T’hyptë vetja në qejf!”
Ndryshe në mitologji
Nga e para fjalë e urtë
Si pasojë në vendngjarje,
Lule mbi plot hijeshi.
Nga e dyta,
Kohë e sotme
Për lule jo që s’bëhet
Fjalë
Por s’të do më
Njeri pranë.
Kroje atëherë,
Kroje tani,
Prandaj s’na lënë
Të shihemi në ujë.
Se qenka njësoj
Sikur të hash,
(a të provosh)

Mollën e ndalueme...

Viti '97

(Kurorë kalimtare e qiellit)

Krismat e armëve
Breshëri,
Kurorë kalimtare
E qiellit,
E nëse s'kanë ku
Varen
Si mbas dasme
Ngulen qorrazi
Në tokë,
A në mish njeriu
Pa fat.

Mallkim është ky?
Nga kush,
Që paqen e natës
Gris,
Qetësinë e ëndërrimeve
Të prishë.
Ky s'është bri gjuetie

Mbi kuaj e qen
Të azdisur.

Mallkimin le ta
Prishin,
Që vdekja të tjetërsohet!
Kurora kalimtare
Divorc natës i bën
Sa shohin diellin
Vezullues,
Gazmor naiv
Me të.

Drini e Valbona

Drinin tani afër
Kemi parë,
Mbi të me traget
Unë udhëtoja.
E kisha dëgjuar
Si Drini plak,
Por kjo për Drinin
Është e huaj.
Dhe Drini jo i kaltër,
Por i gjelbër,
I ri, i bukur,
I furishëm,
Vë në lëvizje
Turbina,
Mban pyjet e larta,
Të gjelbra.
E dëgjoni gurgullimën?

“Mos thoni se jam
I plakur,
Fuqishëm mbi
Turbina kërcej.
Valbonën bukuroshe.
Nuse kam!”

Lëkundje personaliteti

Një zile, bie telefoni
Je ti, që më pyet si jam!
Në djall vaftë kujdesi,
Miklimi yt fare i kotë,
Si je? - pëshpërit ngadalë.
Një insistim fals, i kotë.
Çfarë të përgjigjem?
Jam mirë,
Derisa marr frymë në tokë.
Një zë i largët, i ftohtë
Dikur plot ngrohtësi.
S'më kish mbetur
Më asnjë ndjenjë,
Vetëm tani e tutje
Harrim.

Vit kovidian

Çdo ditë e ngarkuar
Me ankth e dëshpërim!
E thirrja: “Kujdes kini!”.
Më e fortë, më rrëqethëse
Po oshtinte!
Sirena e ambulancave
Si alarme luftime
Kandrra është ajo
Që po na sulmon!

Si të ruhem kur ekziston,
Si të ruhem kur ajër thithim,
E thirrja prapë: “Kujdes kini!”.
Më e fortë, më rrëqethëse ushton!

E biseda e ditës fjalor i përgjysmuar
Tri fjalë kanë mbetur harruar,
Të varura te një pemë
E Vitit të Ri të kaluar:
Maska,
Distancim
Izolim...

Kovidi, kohë e zymtë

Si lopatat që shtyhen varkat
Ashtu njerëzit bëjnë me ditët,
Si gjithë lumenjtë rrjedhin
Ashtu ikin edhe vitet.
Kalendarët busulla e jetës janë
Të varur në muret e çdo shtëpie
Ku amvisat shënojnë
Datat, ditëlindjet, gëzimet, festat
Me shirit të zi edhe vdekjet.
Vrapon si retë koha
Horizonti i fsheh
E koha në jetët e njerëzve nëpër stinë,
Si retë kalon.
Një garë e madhe, stafetë jeta jonë
Kjo lëvizje quhet ritëm,
Prandaj si lopatat që voziten varkat
Ashtu njerëzit bëjnë me jetën.

Nostalgi

A thua harrohet
Kur bulevardin merrnim me gaz,
Kur gjethet shkelnim anash trotuarit,
Kur shikime na hidhnin,
E na skuqeshin faqet,
Me dashurinë që formohej
Si syth në zemër?!

Gratë laajnë me ndjenjat

Më mirë mos u anko
Që të marrësh
Përgjigje të përcipta,
Që vendosin veten
Në diskutim.
Mos ji kërkuese
Kur nuk i ke të qarta
Gjërat vetë ti e para.
Mos kujto se ke përballë
Një armik të largët
E ti gjendesh gjithmonë
Në pritje që të mos të
Humbë sensi.
Krenari e kotë, xheloz
Prej gruaje.
Uthulla thyen enën
E vet.
Në qoftë se s'njeh
Veten,
S'ke si të arrish
Te tjetri.

Heshtje tinëzare

Në jam keq sot
Mos më thuaj,
- Por dje ishe mirë.
Në isha i dashur,
I kuptueshëm
Dje?
Sot buza s'më qesh
Dot.
Më lër në strofullin tim
E dashur grua.
I mbyllur në vetvete,
Do dal sa retë të
Largohen.
Por mos mendo
Se s'të dua
E mos e ngatërro
Dashurinë, me heshtjen...

Fragile

Gruaja si pjergull,
Lastar-lastar
Degëzuar,
Si ujët e burimit,
E në të thahen buzët
Ti pi, e etjen e shuan.

Në je i përhumbur
Ndiqe dritën e saj,
Me dritë i ndriçuar.
Nëse i kalon pranë!

E në të lodh kuptoje,
Mos u mundo ta njohësh,
Vetëm rriji pranë.
Bëji një serenatë,
Puthe buzë e faqe,
Pa ditur do ta kuptosh
Një jetë po i ngjan...

Grua luftëtare

Brenda meje noton trishtimi,
Në dallgë vetmie e ndiej
Fshehur rriURREJTJA,
Që si shpend grabitqar
Më tërheq nëpër skuta.
Si kancer t'më heqë zvarrë

Fuori dolor;

Fuori dolor;

Ti s'më mund dot...

Përdor moton,

Me dy gishta lart

Fuori dolor;

Dolor fuori!

Tri hyjneshat e fatit

O Zoti im në qiell,
Nuk dua të të mërzis,
Të të kërkoj pasuri,
Flori, pushtet,
Gjërat që janë më të
Dëshirueshme për
Shumicën e njerëzve
Në këtë botë.
Por unë dua të di
Si në poemat e
Homerit,
Fatin tim e kanë
Shkruar Zanat.
Prandaj un s'qaj,
Nuk ngas me vrap,
Nuk dua të shpejtohem.
Më shumë më duhet
Dituria,
Të këndoj si në poema,
Edhe kultura

Që të besoj te fati
E te Zanat,
Atëherë do jem gati,
Fatalitetin mos ta
Njoh,
Të takohem me
Dashurinë.
Do jetë ditë speciale,
Dita e dashurisë.
Prandaj nuk do të
Ngutem,
Nuk do të ngas me
vrap.
Ditën që unë linda
Zanat kisha pranë.

Kur shikon një film

Më kot vrapon e lodhesh
Mbas hënës gënjeshtare,
Ngrysesh edhe zgjohesh
Me hesapet lajkatare.

Më kot vrapon e lodhesh
Pas hënës gënjeshtare,
Nuk bën më hesape,
Kur ke të vërtetën
Përpara...

Pensioni

Po vjen koha
Që rrota nën këmbë
Të më mbathin,
Dhe të largohem
Në heshtje.
Më duket që tani
Sa vetëm e mendoj,
Po më bëhen të largët
Jo më kur ta provoj,
Më duket se si vjen
Më keq njeriu,
Do harrohem si një
Gardërobë e vjetër.
Dikush emrin tim
Mbi ndonjë fustan
ta lexojë,
Do thonë ka qenë
Dikur... (një soprano)
Me këtë emër!
Tani, mbi të,
Një emër tjetër
Kanë shkruar...

Rrotullimi i botës

Shihe si ecën madhështor
I sigurt për bëmat e tij.
Të gjithë e dëgjojnë
E duartrokasin:
“Ej komandant,
Dua fëmija im të të ngjajë!”
Por bota rrotullohet
Dhe ja ku është:
Më nuk po ecën!
Më nuk po e shohim si dikur.
Diku ka shkelur
Në dërrasë të kalbur...
“Mashtruesi!”
Iku shkëlqimi i rremë,
Të gjithë të grumbulluar
Me shenjë të gishtit poshtë,
Kërkonin thyerjen e lapsit
Po ata njerëz që i dhanë lavdinë.

Lost

Njeriu i trazuar është si anije
Që lundron në ujëra të thella,
Dhe vjen një ditë humb busullën
Që fillon dalëngadalë
Të zhduket në horizont,
Më s'e gjen dot bregun e tij
Perëndim dielli i thonë.

Metaforë

Plumbi vret, tmerr sjell
Forca prish, kocka thyen.
Por nga fjala e rëndë
Nuk shërohesh kurrë,
Mbetesh i gjymtuar
Si një pyll pa drurë!

Dhimbje

Vdes njeriu...
Për të qarë
Nëna, babai, vëllezërit,
Nusja, bijtë,
Shoqëria,
Vdes e nuk të pyet
Sa dhimbje, sa mall
Sjell ikja e tij!
Vdes, e vdekjet
Të ndryshme janë.
Lotët njësoj derdhen
Vajet ato fjalë
Kanë.
Vdekja, hije e zezë
E njeriut,
Vardiset në çdo hap,
Në çdo skaj,
Harresa bën të jetë
Gëzimi,
Se vdekja të saj
Të ka.

Perëndim dielli në Vlorë

Një aparat fotografik
Më bëri të mbaj mend
Perëndimin e diellit.

Përflakur tutje humbi
Sikur u shuajt në det!

E kuqërremta stoike,
Midis shkëmbinjve të detit,
Regëtinte përjetësinë
Në momentin e fundit të ditës.

Vlora ime,
Qyteti i argjendtë!

Por prapë vazhdonte
Të më fiksonte.
Një pemë të zhveshur
Tek-tuk me fletë,
Që qëndronte stoike.

E prapë, e prapë
Mrekullohesha.
Një rreth harkor
Që i rrinte besnik
E madhështor
Detit pa anë, ku vapa
E freskia ishin shoqe.

Vlorë, e bukura Vlorë,
Nga këto bukuri
Të njoh.
Sa më shumë
Ikin vitet
Ti mbetesh qyteti
I argjendtë.
Ti qytet i argjendtë
Mbetesh.